

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Gjuha arabe I

**Programi i studimit:** Teologji Islame

**Numri i ECTS kredive:** 5

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 103

**Fondi i orëve:** 3+2

**Viti akademik:** 2026/2027

**Semestri:** I

**Mësimdhënësi:** Mr. Hysni Beka

### Qëllimi dhe përmbajtja e shkurtër e lëndës

#### **Përshkrimi i Lëndës**

Lënda **Gjuha Arabe** zë vend qendror në këtë fakultet për shkak se është gjuha burimore e Kur'anit dhe Hadithit, si dhe e të gjitha lëndëve fetare. Ky modul u jep studentëve të vitit të parë njohuri themelore mbi gjuhën arabe, si nga aspekti teorik ashtu edhe praktik.

Nëpërmjet kësaj lënde, studentët aftësohen në drejtshkrim, shqiptim dhe komunikim të saktë në gjuhën arabe.

#### **Qëllimet e Lëndës**

Qëllimi i lëndës është fuqizimi i kompetencave gjuhësore dhe komunikative të studentit, në mënyrë që të jetë i aftë të realizojë qëllime të ndryshme komunikuese.

#### **Kompetencat e Synuara**

##### **1. Kompetenca Gjuhësore**

- Përvetësimi i rregullave gramatikore, semantike, fonetike dhe ortografike.
- Pasurimi i fjalorit dhe shprehive të të folurit.

## 2. Kompetenca Socio-Gjuhësore

- Të kuptuarit e dimensionit shoqëror të gjuhës.
- Aftësimi për përdorimin e gjuhës në situata të ndryshme komunikimi dhe në akte të ndryshme ligjërimore.

## 3. Kompetenca Pragmatike

- Zotërimi i rregullave dhe parimeve mbi të cilat ndërtohet dhe organizohet mesazhi.
- Aftësimi për të zhvilluar temën, për të lidhur logjikisht idetë dhe për të mbajtur koherencën e mendimeve.
- Përdorimi i gjuhës për funksione të ndryshme komunikuese si: kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi i ndihmës, shprehja e dakordësisë, përshëndetjet etj.

### **Rezultatet e pritura të nxënies:**

Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të:

1. **Njohë bazat themelore të gjuhës arabe** – duke përfshirë alfabetin, rregullat e drejtshkrimit dhe strukturat gramatikore kryesore.
2. **Lexojë dhe shkruajë në gjuhën arabe** me saktësi dhe rrjedhshmëri elementare.
3. **Përkthejë në mënyrë të pavarur** tekste të thjeshta nga arabishtja në shqip dhe anasjelltas.
4. **Komunikojë në mënyrë bazike në arabisht** në situata të përditshme dhe akademike, duke përdorur shprehje dhe fjalor themelor.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

Mësimdhënia zhvillohet përmes një kombinimi të metodave tradicionale dhe bashkëkohore, duke u fokusuar në përfshirjen aktive të studentit. Metodot kryesore përfshijnë:

- **Ligjërata interaktive** – prezantim i koncepteve teorike me përfshirje të pyetjeve dhe komenteve të studentëve.
- **Ushtrime praktike** – përvetësim i rregullave gjuhësore përmes shembujve dhe detyrave konkrete.
- **Biseda dhe diskutime** – ushtrime të komunikimit verbal dhe zhvillim i aftësive dialogjike në gjuhën arabe.

- **Punë në grupe** – zhvillimi i bashkëpunimit mes studentëve përmes aktiviteteve praktike dhe projekteve të shkurtra.
- **Hulumtime të drejtuara** – kërkimi i fjalive, definicioneve dhe koncepteve në burime të shkruara në gjuhën arabe për të forcuar aftësinë e leximit dhe kuptimit.

### Detyrat e Studentëve

- Studentët do të kenë **detyrë shtëpie** të rregullt për të përforcuar mësimin.
- Studentët obligohen të kryejnë **hulumtime individuale** nga burime të ndryshme në gjuhën arabe dhe të paraqesin gjetjet e tyre gjatë orës.

### **Përmbajtja e lëndës:**

#### Java e parë

- Prezantim me lëndën, tematikat dhe metodologjinë.
- Njohuri mbi aftësitë gjuhësore, psikolinguistikën dhe bazat e të nxëniet të gjuhës së dytë.
- Njohuri mbi gjuhët semite dhe veçoritë e tyre.
- **Njësia I:** Përshëndetje dhe njoftim (fq. 1–26).

#### Literatura:

Nga zinxhiri i mësimin të gjuhës arabe për të huaj: “**Arabia bejn jedejk**” (“Arabishtja në duart tuaja”), Libri i nxënësit nr. 1, Pjesa e parë, botuar në Riad – A. Saudite, 2014.

العربية بين يديك – كتاب الطالب (1) – إشراف: د. محمد بن عبدالرحمن آل الشيخ، الرياض، الإصدار الثاني 2014م

#### Java e dytë

- **Njësia II:** Familja (fq. 27–52)

#### Java e tretë

- **Njësia III:** Banimi (fq. 55–80)

#### Java e katërt

- **Njësia IV:** Përditshmëria (fq. 81–89)

#### Java e pestë

- **Njësia IV:** Përditshmëria (fq. 90–108)

- **Njësia V:** Ushqimi dhe pijet (fq. 109–134)

### **Java e gjashtë**

- **Njësia VI:** Namazi (fq. 135–160)

### **Java e shtatë**

- **Njësia VII:** Mësimi (fq. 163–188)

### **Java e tetë**

- **Njësia VIII:** Puna dhe profesioni (fq. 189–214)

### **Java e nëntë**

- **Testi i parë vlerësues**

### **Java e dhjetë**

- **Njësia IX:** Shitblerja (fq. 239–264)

### **Java e njëmbëdhjetë**

- **Vazhdim:** Njësia IX – Shitblerja (fq. 239–264)

### **Java e dymbëdhjetë**

- **Njësia X:** Koha – Stinët (fq. 265–290)
- **Njësia XI:** Njerëzit dhe vendet (fq. 293–318)

### **Java e trembëdhjetë**

- **Njësia XII:** Hobit (fq. 319–344)

### **Java e katërbëdhjetë**

- **Njësia XIII:** Udhëtimi (fq. 347–372)
- **Njësia XIV:** Haxhi dhe Umra (fq. 373–398)

### **Java e pesëmbëdhjetë**

- **Njësia XV:** Shëndeti (fq. 401–426)
- **Njësia XVI:** Pushimi (fq. 427–452)

- **Përsëritje dhe përkthime**

## **Përmbledhje Gramatikore**

1. Pjesët e ligjëratës (emri, folja, pjesëza)
2. Veçoritë e emrit
3. Kategoria e rasës
4. Emrat në rasën emërore
5. Emrat e shquar
6. Kryefjala e fjalisë emërore dhe llojet e saj
7. Kallëzuesi dhe llojet e tij
8. Folja, kohët dhe llojet e saj
9. Rasa kallëzore e emrit
10. Kundrinori dhe disa lloje të tij
11. Rasa gjinore e emrit
12. Kryefjala dhe zëvendës-kryefjala e fjalisë foljore
13. Pjesëzat

**Shënim:** Në fund të semestrit bëhet përsëritje dhe sqarim i rregullave gramatikore të përfshira gjatë mësimit të librit nr. 1.

### **Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 20%

Kolokviumi : 40%

Provimi final: 40%

**Total 100%**

### **Literatura obligative:**

Nga zinxhiri i mësimit të gjuhës arabe për të huaj, me titullin:

**“Arabia bejn jedejk”** (*Arabishtja në duart tuaja*) – Libri i nxënësit nr. 1 dhe nr. 2, botimi i dytë, 2014, Riad, Arabia Saudite.

### Referenca origjinale në arabisht:

العربية بين يديك – كتاب الطالب (1 و 2) – الإصدار الثاني، 2014م  
إشراف: د. محمد بن عبدالرحمن آل الشيخ، الرياض

### Literartura shtesë:

- **Kurani me përkthim në gjuhën shqipe** – Sherif ef. Ahmeti
- **Qazimi, Qazim (Prof. Dr.)** – *Gramatika e gjuhës arabe (Morfologji dhe Sintaksë)*, Prishtinë, 2014
- **Mehdiu, Feti** – *Gjuha arabe*, Prishtinë, 1990
- **Memishi, Isa (Dr.)** – *Fjalori Arabisht–Shqip* (Vëll. I–II), Shkup, 2011
- **Fjalorë në gjuhën arabe:**
  - الفيروز آبادي – معجم القاموس المحيط – përpiluar nga